

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Mars 2023

**Tiranë, më 25 Prill 2023:** Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Mars 2023, janë 846.645. Ky tregues rezulton me një rritje 33,8 %, krahasuar me Mars 2022. Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Mars 2023, janë 842.428, duke shënuar një rritje me 22,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


### Hyrjet e shtetasve

Në Mars 2023, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 462.617. Ky numër është rritur me 29,6 %, krahasuar me Mars 2022.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 384.028. Ky numër është rritur me 39,2 %, krahasuar me Mars 2022.

Gjatë tremujorit të parë 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 1.070.564. Ky numër është rritur me 59,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 (tab.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Mars 2022- Mars 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Për publikim 25/04/2023

**Daljet e shtetasve**

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Mars 2023 janë 462.483. Krahasuar me Mars 2022, ky tregues është rritur me 19,2 %.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Mars 2023, janë 379.945. Krahasuar me Mars 2022, ky tregues është rritur me 26,2 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë tremujorit të parë 2023, është 1.394.250, duke u rritur 32,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

**Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Mars 2022	Mars 2023	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Mars 2022	Janar-Mars 2023	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje gjithsej</b>	<b>632.961</b>	<b>846.645</b>	33,8	<b>1.545.984</b>	<b>2.375.341</b>	53,6
Shqiptarë	356.985	462.617	29,6	874.774	1.304.777	49,2
Të Huaj	275.976	384.028	39,2	671.210	1.070.564	59,5
<b>Dalje gjithsej</b>	<b>689.064</b>	<b>842.428</b>	22,3	<b>1.790.314</b>	<b>2.490.382</b>	39,1
Shqiptarë	388.067	462.483	19,2	1.053.690	1.394.250	32,3
Të Huaj	300.997	379.945	26,2	736.624	1.096.132	48,8

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Mars 2023, rajoni me numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri është rajoni i Evropës me 369.935 shtetas, pasuar nga Amerika dhe Azia Lindore /Paqësori, përkatësisht me 8.952 dhe 2.183 shtetas (tab.2).

**Tab .2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit**

Periudha	Mars 2022	Mars 2023	Janar - Mars 2022	Janar - Mars 2023
<b>Gjithsej</b>	<b>275.976</b>	<b>384.028</b>	<b>671.210</b>	<b>1.070.564</b>
I . Afrika	168	450	500	1.475
II. Amerika	5.948	8.952	14.463	22.253
III.Azia Lindore dhe Paqësori	906	2.183	2.482	4.854
IV.Lindja e Mesme	643	562	1.382	1.428
V. Azia e Jugut	424	842	867	1.816
VI. Evropa	267.508	369.935	650.247	1.036.249
- Evropa Qëndrore / Lindore	8.161	11.737	18.539	28.829
- Evropa Veriore	9.836	12.461	22.644	30.059
- Evropa Jugore	231.636	319.348	565.136	910.107
- Evropa Perëndimore	13.141	17.246	31.870	42.350
- Evropa Lindore / Mesdheut	4.734	9.143	12.058	24.904
VII. Rajone të paspecifikuara	379	1.104	1.269	2.489

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Mars 2023, krahasuar me Mars 2022, hyrjet e shtetasve të huaj janë rritur:

- për qëllime personale me 39,9 %;
- për qëllime pushime, vizitë tek të afërm, etj. me 38,9 %;
- për biznes dhe qëllime profesionale me 20,4 % (tab.3).

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Periudha	Mars 2022	Mars 2023	Ndryshimi vjetor (%)	Janar - Mars 2022	Janar - Mars 2023	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje Shtetas të Huaj</b>	<b>275.976</b>	<b>384.028</b>	<b>39,2</b>	<b>671.210</b>	<b>1.070.564</b>	<b>59,5</b>
I. Personale	266.059	372.090	39,9	647.177	1.042.609	61,1
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.	255.173	354.429	38,9	620.652	993.464	60,1
2. Trajtime shëndetësorë	147	25	-83,0	385	180	-53,2
3. Qëllime fetare	36	22	-38,9	81	80	-1,2
4. Udhëtarë transit	10.703	17.614	64,6	26.059	48.885	87,6
II. Biznes dhe profesionale	9.917	11.938	20,4	24.033	27.955	16,3

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

## Përkufizime

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet:** Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

**Vizitor:** Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

*Qëllime personale* të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.;
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

*Kategoria e biznesit* që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

[http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika\\_e\\_Revizionimit\\_Statistikor](http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor).

**Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:**

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.